



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) dhe nenit 12 dhe 21 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2014 miratoi si në vijim:

RREGULLORE

MBI PAGESËN E PENSIONEVE INDIVIDUALE TË KURSYERA

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kushteve për pagesën e pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, si dhe ofruesit e pensioneve plotësuese individuale. Gjithashtu kjo Rregullore përcakton kushtet e pagesave të shumave totale dhe pagesat fazore para se të jenë në funksion kontratat e anuiteteve, si dhe pagesat nëpërmjet kontratës së anuitetit në Kosovë.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondin të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Ofruesit e Pensioneve që ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale (“Ofruesi i Pensioneve”).

Neni 2

Përkufizimet

Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe (në vijmë Ligji për Fondet Pensionale) ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

Anuitet - nënkupton një policë sigurimi të cilën një pjesëmarrës e ka blerë nga një kompani e sigurimit jetësor e shprehur në formë të pagesave mujore për tërë jetën e pjesëmarrësit ose të përfituesit të tij siç është paraparë në Ligjin për Fondet Pensionale.

“**Anuitanti**” nënkupton individin në llogarinë e të cilit bëhet pagesa e anuitetit, e cila

është kalkuluar dhe përcaktuar. Në jetën e përbashkët ose anuiteti për atë që mbetet gjallë, termi “anuitant” përfshin të gjithë individët e emëruar si anuitant në kontratën e anuitetit për të mbuluar ata individ që vdesin të fundit (pas bashkëshortit apo bashkëshortes).

“**Kontrata e anuitetit**” nënkupton marrëveshjen, e lidhur ndërmjet kompanisë së sigurimit jetësor dhe anuitantit, nëpërmjet së cilës kompania garanton të bëjë disa shuma fikse të pagesave të rregullta për anuitantin ose përfituesin, perioda e pagesës është e determinuar ose fikse.

“**Përfitues**” – nënkupton një person fizik të cilin e ka caktuar pjesëmarrësi ose kur pjesëmarrësi nuk ka caktuar askënd apo nëse përfituesi i caktuar vdes para pjesëmarrësit, atëherë pjesëmarrësi e trashëgon atë, i cili ka fituar ose mund të fitojë të drejtën në mjetet pensionale në bazë të të drejtave të pjesëmarrësit.

“**Pensioni invalidor**” nënkupton të drejtën për të filluar beneficionet e pensionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi për pjesëmarrësin, të cilit i është caktuar invaliditeti i definuar në Ligjin mbi Pensionin Invalidor, që i jep asaj/atij të drejtën për pension invalidor.

“**Anuiteti mujor i menjëhershëm**” nënkupton pagesën mujore të anuitetit që fillon brenda periudhës prej 30 ditësh prej datës së kontratës së anuitetit.

“**Jeta e përbashkët ose anuiteti për atë që mbetet gjallë**” nënkupton një kontratë të anuitetit ku janë dy ose më shumë anuitant.

“**Pagesat fazore**” nënkupton pagesat mujore të shumave që janë në një llogari individuale nëpërmes kontratës bankare ose rregullimit tjetër të aprovuar nga BQK-ja.

“**Opcionet e zgjedhjes**” nënkupton dispozitat e veçanta në një kontratë të anuitetit që përshkruan opsionet alternative për zgjedhjen e formës dhe mënyrës me të cilën pagesat e anuitetit janë bërë, llogaritur dhe përcaktuar.

“**Anuiteti i jetës së vetmuar**” nënkupton kontratën e anuitetit ku është vetëm një anuitant.

“**FKPK**” nënkupton Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

“**Ofruesi i pensioneve**” - nënkupton institucionet financiare, bankat, instrumentet për investime të hapura dhe kompanitë e sigurimeve, që sigurojnë pensionet plotësuese individuale në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale.

“**Supozimet Aktuariale**” nënkupton një sërë vlerësimesh që janë shfrytëzuar për të llogaritur kontributet për të përcaktuar benefitet e pensionit në rregullimin pensional me Benefit të Definuar. Kjo lidhet me zhvillimet e ardhshme që ndikojnë në financimin e benefiteve të pensionit ku faktorët, në mes tjerash janë: shkalla e interesit, shkalla e mortalitetit, shkalla e invaliditetit dhe ndryshimet në koston e jetesës.

“**Pensioni i shtyrë**” nënkupton benefitin e pensionit të rezervuar për pjesëmarrësin pas përfundimit të pjesëmarrjes së asaj/atij në programin e Pensionit Plotësues Individual, që shfaqet para moshës së pensionit mirëpo për të cilën fillimi i pagesës së pensionit shtyhet derisa ajo/ai arrin moshën e pensionit.

“**Mosha e Pensionit**” nënkupton moshën e pensionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi.

“**Benefiti i pensionit normal**” nënkupton benefitin e pensionit për pjesëmarrësin që ka filluar pasi që ai/ ajo ka arritur moshën e pensionit.

Neni 3

Pagesa e pensionit mujor e siguruar nga FKPK-ja dhe Ofruesit e Pensioneve

3.1 Dispozitat e përgjithshme

- a) Pagesa e Pensioneve duhet të fillojë kur pjesëmarrësi arrin moshën e pensionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi ose më herët kur ajo/ai e vuan kualifikimin e paaftësisë që e bënë atë të pranueshëm për pension invalidor.
- b) Nëse pjesëmarrësi ka kursime të mjaftueshme për të blerë një anuitet dhe janë disa kompani për sigurim jetësor të licencuar nga BQK-ja, për ofrimin e pensioneve individuale të kursyera, pjesëmarrësi do të jetë i lirë që të zgjedhë njërën prej kompanive të sigurimit jetësor, që sigurojnë anuitet me të cilën ajo/ai kontraktin për anuitet. FKPK dhe ofruesit e pensioneve do të paguajnë ose transferojnë bilancin e llogarisë individuale të pjesëmarrësve në kompaninë e zgjedhur të sigurimit për të blerë anuitetin për pagesën e pensionit të pjesëmarrësit.
- c) Pagesa e pensioneve mujore për pensionistët ose përfituesit(ve) të atij/asaj duhet të bëhet sipas termeve të kontratës së anuiteit.
- d) Nëse nuk ka sigurues të anuiteit në Kosovë ose pjesëmarrësi nuk ka kursime të mjaftueshme për të blerë një anuitet, FKPK dhe ofruesit e pensionieve , do të bëjnë pagesën e menjëhershme ose përmes tërheqjes në faza sipas kësaj Rregulloreje.
- e) FKPK dhe ofruesit e pensioneve duhet të njoftojë pjesëmarrësin me shkrim për afrimin e moshës së tij pensionale sipas nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit për Fondet Pensionale. Në rast të pensionit invalidor pjesëmarrësi duhet të njoftojë fondin dhe Ofruesit e pensionit për kualifikimin e invaliditetit.

Neni 4

Forma e pagesës se pensioneve përmes tërheqjes në faza

4.1 Fondi dhe ofruesit e pensionit mund të krijojnë rregulla që të kryejnë pagesat e benefiteve të pensionit ndryshe nga blerja e kontratës së anuitetit në rastet kur:

- a) Vlera në llogarinë individuale të pjesëmarrësit është 2,250 Euro ose më pak, Fondi dhe ofruesit e pensioneve mund të paguajnë shumën totale.
- b) Vlera e kontributeve pensionale në llogarit individuale të pjesëmarrësve është më e lartë se 2,250 euro deri në 15,000 euro pjesëmarrësi gëzon të drejtën e tërheqjes përnjëherë 20% të shumës së mjeteve pensionale nga llogaria individuale, ndërsa pjesa e mbetur e mjeteve duhet të paguhet përmes programit të tërheqjes në faza të propozuar nga Fondi dhe ofruesit e pensioneve, i cili duhet të aprovohet nga BQK-ja.
- c) Vlera në llogarinë e pjesëmarrësit është mbi 15,000 euro pjesëmarrësi gëzon të drejtën e tërheqjes përnjëherë 20% të shumës së mjeteve pensionale nga llogaria individuale, ndërsa pjesa e mbetur e mjeteve duhet të paguhet përmes programit të tërheqjes në faza e shprehur në përqindje e bilancit të llogarisë propozuar nga Fondi dhe ofruesit e pensioneve, i cili duhet të aprovohet nga BQK-ja.

4.2 Për pjesëmarrësit që kanë fituar statusin e invaliditetit para moshës së pensionimit, FKPK-ja duhet të bartë pjesërisht bilancin e kontributeve për pagesa fazore për at kohë sa është përcaktuar invaliditetit nga komisioni përkatës.

4.3 Pagesat fazore për pensionin invalidor llogariten sipas programit të tërheqjes në faza të shumës minimale të propozuar nga Fondi dhe ofruesi i pensionit i cili aprovohet nga BQK-ja.

4.4 Pagesa mujore minimale nuk duhet të jetë më e vogël se pensioni bazë që paguhet në Republikën e Kosovës. Propozimi bëhet nga industria e pensioneve dhe aprovohet nga BQK-ja.

4.5 Pagesa e kontributeve është bërë në emër të përfituesit ose përfituesve të pjesëmarrësit, i cili ka vdekur para moshës së pensionimit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi ose para arritjes në planin e pagesave fazore ose të kontratës efektive të anuitetit për pagesën e pensionit të asaj/atij, shuma nga llogaria individuale e pjesëmarrësit mund të transferohet në llogarinë individuale të përfituesit, nëse kështu zgjedh përfituesi. Shuma që është në llogarinë individuale gjithashtu, mund të paguhet në formë të dhënies se shumës së përgjithshme apo në formë të tërheqjes fazore sipas pikave a, b dhe c të këtij paragrafi, në rast se kështu zgjedh përfituesi.

4.5 Pjesëmarrësi që është duke pranuar pagesa fazore vdes para pranimit të vlerës që

gjendet në Llogarinë Individuale, pagesat e mbetura fazore do t'i paguhen përfituesit/ve.

Neni 5

Forma dhe lloji i kontratës së anuitetit

- 5.1 Kontrata e anuitetit për pagesën e anuitetit duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar ndërmjet kompanisë për sigurimin e jetës dhe anuitantit;
- 5.2 Kontrata e anuitetit duhet të jetë për një anuitet mujor të menjëhershëm, që ofron opsionet për zgjedhjen e llojit të kontratës së anuitetit;
- 5.3 Llojet e kontratës së anuiteti janë si vijon:
 - a) Kontrata e anuitetit të jetës së vetmuar me periudhë të pacaktuar, përfshin pagesën mujore të anuitetit, që bëhen deri në vdekje të anuitantit të emëruar. Pagesat e tilla janë llogaritur dhe përcaktuar në metodat statistikore të jetëgjatësisë së anuitantit.
 - b) Kontrata e anuitetit për jetë të përbashkët ose anuiteti për atë që jeton më gjatë, përfshin pagesat mujore të anuitetit që bëhen deri në vdekjen e anuitantit të fundit. Pagesat e tilla janë llogaritur dhe përcaktuar duke u bazuar në metodat statistikore të jetëgjatësisë së anuitantit të emëruar i cili pritët, që të jetojë më së gjati prej anuitantëve të emëruar.
 - c) Kontrata e anuitetit për periudhë të caktuar përfshin pagesat e anuitetit, që janë të garantuara për numrin fiks të viteve ose të muajve. Llogaritja dhe përcaktimi i pagesave nuk varet nga jetëgjatësia e anuitantit, por kjo bazohet vetëm në gjatësinë e periudhës së specifikuar për të cilën duhet të bëhen pagesat e rregullta mujore të anuitetit. Nëse anuitanti vdes gjatë periudhës së caktuar, pagesat e garantuara të papaguara i paguhen përfituesit(ve) të emëruar.
 - d) Kontrata e anuitetit të jetës së vetmuar me periudhë të caktuar përfshin pagesat mujore të anuitetit, që janë garantuar për periudhën e specifikuar (periudhë të caktuar) dhe nëse anuitanti jeton më gjatë se ajo periudhë, pagesat mujore të anuitetit vazhdojnë deri në vdekje të atij/asaj.
 - e) Kontrata e anuitetit të jetës së bashkuar përfshin pagesat mujore të pensionit të garantuar për periudhë të specifikuar (periudhë të caktuar) dhe nëse pas përfundimit të asaj periudhe të caktuar, ndonjëri prej anuitantëve të bashkuar është ende gjallë, pagesat mujore të anuiteteve vazhdojnë deri në vdekje të anuitantit të fundit. Nëse në çfarëdo kohe gjatë asaj periudhe të caktuar asnjëri prej anuitantëve nuk mbetet gjallë, pagesat e anuiteteve të garantuara të papaguara i paguhen përfituesit të emëruar.

Neni 6

Kushtet dhe kufizimet e aplikueshme për kontrata të anuitetit

6.1 E drejta e pjesëmarrësit që të zgjedhë llojin e kontratës për anuitet varet nga kushtet si vijojnë:

- a) Pjesëmarrësi i cili në fillim të pensionit të atij/asaj, ka bashkëshortin me të cilin është martuar në periudhë së paku një vit para arritjes së moshës së pensionit (ose pensionit invalidor) mund të zgjedhë vetëm llojin e kontratës si më poshtë:
 - (i) Kontratë e anuitetit për jetë të përbashkët ose anuitet për atë që mbetet, që jeton më gjatë.
 - (ii) Kontratë e anuitetit për jetë të përbashkët ose anuitet për atë që jeton më gjatë, me periudhë të caktuar, me bashkëshortin/bashkëshorten si anuitant i përbashkët.
- b) Kontrata e anuitetit me periudhë të caktuar, që nuk varet nga jetëgjatësia, nuk mund të jetë më i shkurtër se (5) pesë vite dhe është në dispozicion vetëm si opSION i zgjedhjes për pagesën e anuitetit nëse shuma e pensionit mujor, që aplikon opSIONIN e anuitetit të jetës së vetmuar është më e vogël se shuma që është paguar si pension bazë në Kosovë në vitin kur pjesëmarrësi e arrin moshën e pensionit.
- c) Lloji i kontratës së anuitetit i përzgjedhur, nuk mund të ndryshohet.

Neni 7

Dispozitat tjera për kontratat e anuitetit

7.1 Shkallët e anuitetit duhet të llogariten, përcaktohen dhe publikohen duke u bazuar në kombinimin e faktorëve si vijojnë:

- a) Moshën e anuitantit ose anuitantët në rast të jetës së bashkuar të anuitetit të atij që jeton më gjatë.
- b) Periudha e caktuar për pagesat e garantuara.
- c) Shkalla e garantuar e interesit, jo më e vogël se 3% për vit.
- d) Shuma e siguruar si pjesëmarrje e profitit e mbajtësve të anuitetit në pajtim me parametrat e parashkruara me rregulloret e BQK-së.
- e) Shuma e fondeve në llogaritë individuale të pjesëmarrësit që shfrytëzohet për të blerë anuitetin.

7.2 Shkalla e anuitetit duhet të jetë e njëjtë për të gjithë individët dhe nuk duhet të ketë

diskriminime në baza të shëndetit, gjinisë, racës, religjionit, nacionalitetit ose kritere tjera të ngjashme të anuitantit(ve) ose përfituesit(ve).

7.3 Pagesat e anuitetit duhet të bëhen në baza mujore. Pagesa e parë duhet të bëhet brenda 30 ditësh prej datës efektive të kontratës së anuitetit.

7.4 Dispozitat e kontratës së anuitetit përcaktojnë kohën dhe mënyrën në të cilën kompania e sigurimit jetësor kërkon dëshmi prej anuitantit ose përfituesit(ve), që pranojnë anuitete se është (janë) gjallë. Dështimi i anuiteteve ose përfituesit që të dëshmojë, që ai/ ajo është gjallë, i jep të drejtë kompanisë të pezullojë pagesën e anuitetit për aq kohë sa nuk dëshmohet, që anuitanti ose përfituesi është gjallë. Në rast se anuitanti ose përfituesi dëshmon se është gjallë, kompania e sigurimit të jetës do të bëjë pagesën e anuiteteve në mënyrë retroaktive nga koha kur ka pezulluar pagesën, mirëpo nuk i jap të drejtë kompanisë se sigurimeve që të ndalë pagesën e anuiteteve. Pagesa e pavend ndaj anuitantit të vdekur ose përfituesit është përgjegjësi e kompanisë së sigurimit.

7.5 Shuma e tarifave, që kompania e sigurimit mund t'i ngarkojë në lidhje me dërgimin e pagesave të anuitetit për ata që jetojnë jashtë, dhënia e ekstraktit të llogarisë dhe/ose informatat, që janë kërkuar nga anuitanti apo përfituesi nuk duhet të jenë më të larta se çmimi i arsyeshëm aktual, ndryshe nga ato për të cilat kompania e sigurimit është e obliguar që t'i shërbejë falas, në pajtim me termet e kontratës së tij të anuitetit, ligjit dhe kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Kushtet për sigurimin e kontratave të anuitetit nga ana e kompanive të sigurimit të jetës

8.1 Për të siguruar kontrata të anuitetit kompanitë e sigurimit të jetës duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- a) Të ketë licencë nga BQK-ja për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit të jetës;
- b) Të ketë dhe të mbajë një "Departament të Anuitetit" me staf adekuat me zyrtar dhe nëpunës, që janë të kualifikuar për të administruar anuitetet dhe pensione.
- c) T'i sigurojnë anuitantit një kopje të vlerës së llogarisë të anuitetit së paku në intervalin prej 12 muajsh dhe me së paku dy herë në vit falas nëse ajo kërkohet nga anuitanti.
- d) Të ndajë gjatë tërë kohës, biznesin dhe produktet e mjeteve themelore të anuitetit për pagesat e pensioneve prej të gjitha mjeteve tjera, që i takojnë sigurimit jetësor të tij dhe bizneseve të tjera.
- e) Të mbajë shërbim të një aktuari i pranueshëm nga BQK-ja, që të vërtetojë dhe bëjë vlerësimin e produkteve të anuitetit të shfrytëzuar për të paguar pensionet.

- f) Të ketë dhe mbajë “minimumin e margjinës së solvencës” prej më së paku 125%.
- g) Të sigurojë kontratën e anuitetit për pagesën e pensioneve për të gjithë individët e pranueshëm të pensionit në pajtim me shkallën e tij të publikuar dhe dispozitat e kontratës së anuitetit në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale në Kosovë dhe rregulloret e BQK-së.
- h) Të mos kompensojë ose dhurojë në mënyrë direkte apo indirekte benefite kolaterale për pensionerët potencialë, ose Fondin apo ofruesit të pensioneve, punëdhënësin ose personat e bashkuar të punëdhënësit, si një nxitje ose shpërblim për personat e tillë në blerjen e produktit të tij të anuitetit.

8.2 BQK-ja mundet me rregullore të përcaktojë kushtet dhe kërkesa tjera të cilat do të jenë në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale në Kosovë dhe këtë Rregullore.

Neni 9 Zbatimi dhe Masat Përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregullore do të jenë subjekt i masave të parashikuara me nenin 32 dhe 33 të Ligjit për Fondet Pensionale.

Neni 10 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 11 mbi pagesën e pensioneve individuale të kursyera të datës 16 mars 2006.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Bedri Peci

